

Nr. 10245/ Prot.

Lezhë, më 26 / 10 /2023

**PROCESVERBAL  
PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR PBA-NË 2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR 2024,  
SI DHE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE**

I mbajtur me datë 17.10.2023 në orën 17:00 në ambientet e Bar Restorant “Suli” në autostradë (në Njësinë Administrative Dajç) në vijim të njoftimit të publikuar në Web, përkatësisht në linkun <https://lezha.gov.al/konsultim-publik-per-pba-ne-2024-2026-buxhetin-vjetor-si-dhe-taksat-e-tarifat-vendore/>, me prezencën e panelit prej 9 anëtarësh:

1. Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Pjerin Ndreu,
2. Zv.Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Ermal Pacaj,
3. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
4. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
5. Administratori i Njësisë Administrative Balldre-Z.Redon Gjeloşi,
6. Administratori i Njësisë Administrative Kallmet- Z.Eraldo Marku,
7. Administratori i Njësisë Administrative Dajç- Z.Paulin Gazulli,
8. Administratori i Njësisë Administrative Ungrej- Z.Agustin Zefi,
9. Administratori i Njësisë Administrative Blinisht- Z.Pjetër Gjini,

drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe kryetarë të fshtrave, banorë dhe përfaqësues të bizneseve nga njësitë administrative Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç dhe Ungrej.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili në fjalën e tij u shpreh për pritjen e propozimeve nga komuniteti për projekt buxhetin afatmesëm, buxhetin e vitit 2024 si dhe paketen fiskale për 5 njësitë administrative. Theksoi se pas një mandati të parë të vështirë me pandeminë, krizen ekonomike etj. tashmë do të investohet me projekte aty ku është më domosdoshmëri ndërhyrja. Referuar krahasimeve ndërmjet shpenzimeve në investime dhe të ardhurave të mbledhura nga taksat, për njësitë administrative rezultojnë këto shifra:

Balldren: rreth 70 milion lekë investime për bujqësinë, rrugët, ndricimin, restaurime, varrezat etj. dhe vetëm 31 milion lekë janë mbledhur nga taksapaguesit. Mund të konsiderohet si një ndër zonat me taksapaguesit më të lartë, përkatësisht në masën 44%.

Dajç: rreth 73 milion lekë investime dhe vetëm 15 milion lekë janë mbledhur nga taksapaguesit.

Blinisht: rreth 72 milion lekë investime dhe paguan 13 milion lekë.

Kallmeti: 60 milion lekë investime dhe paguan 11 milion lekë.

Ungrej: 2 miliardë e 700 mijë lekë investime dhe paguajnë 0.1% taksa.

Kryetari u shpreh se Bashkia Lezhë nuk ka rritur taksat për familjarët dhe bizneset. Është evidentuar një problem gjatë kësaj kohe, mungesa e një database të plotë me të dhënat e bizneseve. Biznese të ndryshme me sipërfaqe të ndryshme paguanin njësoj dhe pas matjeve në terren janë reflektuar ndryshime në vlerën që duhet të paguaj secili biznes sipas sipërfaqes.

Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore prezantoi para të pranishmëve rreth të ardhurave që mblidhen nga kjo zonë dhe orientimet për paketën fiskale. Regjistri i taksapaguesve të zonës përbëhet nga taksapaguesit biznes që zënë mbi 60% të të ardhurave dhe pronarët e ndërtesave për qëllime ekonomike, taksapaguesit familjare taksapagues pranw ujwsjellwsit dhe ata që paguajnë pranë njësive administrative. Numri total i familjeve të taksueshme në këtë zonë është 9645 familje. Paketa fiskale për familjarët ka për objektiv të bëjë një taksim të drejtë dhe të zgjerojë numrin e familjeve që paguajnë taksat dhe të krijohet një rregjistër elektronik për të gjithë familjarët. Në rastin e një familje me një shtëpi me 150 m<sup>2</sup> dhe 300 m<sup>2</sup> truall, taksa e ndërtesës do mblidhte 3,000 lekë/vit, taksa e truallit 168 lekë/vit, tarifë pastrimi 900 lekë/vit, tarifë ndriçimi 250 lekë/vit dhe tarifë mirëmbajtje varrezash 50 lekë/vit pra një total 4,368 lekë/vit. Kjo është pagesa mesatare për një familje në këtë zonë.

Në prezantimin e tij drejtori thekosi se synohet rritja e të ardhurave nga kategoria “biznes”. Aktualisht është krijuar një platformë e digjitalizuar për bizneset dhe njëkohësisht synohet të lehtësohen procedurat e bizneseve pranë Drejtorisë së Taksave. Për biznesin e vogël pagesa mesatare është 18,700 lekë/vit ndërsa për biznesin e madh 333,900 lekë/vit bazuar në parimin që kush qarkullon më shumë lekë të paguajë më tepër. Gjithë zona ka 276 biznese por duhet verifikuar në terren sepse mund të ketë biznese të pa regjistruar dhe faturohen rreth 14 milion lekë (të reja) në vit. Për vitin 2024 do jetë e nevojshme të depozitohen dokumentat e pronësisë mbi shtëpitë e banimit apo godina për biznes për verifikimin e tyre dhe të kushtëzohen në afat pastaj për të kaluar në penalitete për shkak të diferencave në deklaram të pasurisë.

Kryetari i Bashkisë u shpreh se do të ketë një sistem vetëdeklarimi për të krijuar një bazë të dhënash dhe në rast se konstatohen mashtrime do të merren masa. Gjithashtu administrimi i varrezave do ti kalojë bashkisë, do ketë një njësi që do bëjë shërbim në varrezë kundrejt një tarifë. Nëse do ketë vetëm shpenzime dhe jo pagesë taksash Bashkia do të shkojë drejt zhytjesh në borxh. Shpenzimet duhet të shkojnë tek taksapaguesit, duhet të ketë një shpërndarje të drejtë.



Kryetari u shpreh se nga viti në vit do të rriten investimet dhe me zhbllokimin e lejeve të ndërtimit do ketë një faze tjetër zhvillimi. Gjithashtu theksoi se do të zhvillohen takime nga afër me kryetarët e fshatrave dhe vitin e ardhshëm do të ketë një skemë të re për menaxhimin e mbetjeve, do të ketë një mënyrë të re organizimi, ditë dhe orar të caktuar për grumbullimin e mbeturinave, edhe pse Bashkia Lezhë është ndër qytetet më të pastra ka akoma punë për t'u bërë.

### **Mendime/Diskutime**

1. **(Banor i fshatit Dragushë)** ngriti si problematikë kanalet dhe rrugën në fshatin Dragushë.
2. **(Banor i fshatit Gramsh)** shprehu si shqetësimin se fshati Gramsh është i palidhur me asfalt, ka gropa në rrugë. Gjithashtu edhe kanalet që lidhin Zojsin janë të bllokuara si dhe sipas tij nevojiten të bëhen ndërhyrje në qendrën e Gramshit.

Kryetari u shpreh se në rrugën e përmendur janë bërë ndërhyrje si dhe 90 % e kanaleve janë pastruar, pjesa e mbetur do të realizohen në vazhdimësi në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë. Qëllimi është mos të prishen prodhimet e zonës për shkak të përmblytjeve dhe jo vetëm.

3. **(N.K.-Banor i fshatit Mabë)** theksoi që në zonën e Mabës problem është rruga që lidhet me Barbullushin, gjithashtu edhe furnizimi me ujë të pijshëm.
4. **(D.L.-Banor i zonës Mali Kakarriq)** shprehu si shqetësim furnizimin me ujë të pijshëm për zonën e Kakarriqit si dhe sygjeroi që taksat duhet të përfshihen në librezë pasi në rast të kundër banorët nuk i paguajnë.

Kryetari u shpreh se ka 2 vite që është firmosur projekti Gocaj-Kakarriq dhe firma gjermane do të investojë në Lezhë në gjithë kanalet e zeza dhe të bardha, do të investojë Ujësjellin e Kodër Marlekaj dhe Ujësjellësin e Shëngjinit dhe presim që projekti të fillojë përfundimisht pas janarit, por që është shtyrë për shkak të pandemisë.

5. **(F.G.-Banor i fshatit Piraj)** shprehu shqetësimin e tij për mungesën e ujit të pijshëm në fshatin Piraj.
6. **(Banor i fshatit Blinisht)** ngriti si shqetësim pastrimin e ferrave nga autostrada deri tek varrezat e Blinishtit.
7. **(K.Sh.-Përfaqësues biznesi)** në fjalën e tij u shpreh se taksimi i biznesit sipas xhiros e shtyn biznesin të mos jetë real dhe taksimi duhet të jetë në bazë të shërbimit dhe asaj me çfarë merret. Sipas tij problem është edhe kontakimi i vazhdueshëm me administratën tatimore dhe nevojitet një sistem më i organizuar i mbledhjes taksave në mënyrë që të

dhënat të mos humbasin”. Gjithashtu evidentoi edhe nevojën për pompa për vaditjen e zonës duke qenë se ato janë kosto për fermerët.

Në përgjigje të kësaj kryetari theksoi se deri më tani janë pastruar 500 km kanale por duke qenë se territori i Lezhës është shumë i madh do vijojë puna për pjesën e mbetur si dhe po bëhen negociata me ambasadën japoneze për të blerë të tjerë eskavator që të përshejtohet procesi.

Gjithashtu edhe Drejtori i Drejtorisë së Taksave u shpreh se tarifata e shërbimit publik janë për të ofruar shërbimet përkatëse dhe për të mbuluar kostot e saj prandaj është më e llogjikshme që ata që fitojnë më shumë të paguajnë më shumë se ai që fiton me pak. Për taksat e pasurisë qoftë taksë ndërtese apo trualli, Bashkia Lezhë është nën çmimin e vendosur nga VKM, kjo me iniciativë të kryetarit.

Në fjalën e tij kryetari u shpreh se Bashkia Lezhë është një ndër bashkitë me taksat më të ulëta e cila ka synuar zgjerimin e bazës së tatimpaguesve por që nuk është arritur për shkak të metodës manuale që është ndjekur ndër vite, shtyllë kjo e cila do të përmirësohet përmes krijimit të sistemit digjital për të qenë me transparent me publikun. Në përfundim ai deklaroi që së bashku me publikun do të diskutohen parimet mbi të cilat do të përmirësohen disa aspekte me impakt tek komuniteti.

Duke falenderuar pjesëmarrësit, takimi u mbyll nga Kryetari i Bashkisë Lezhë.

Kohëzgjatja: Rreth 70 minuta

Pjesëmarrës: 100 persona Femra: 11

**Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparencës**

Elson Frroku



<sup>1</sup>Koordinator për njohimin dhe konsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj



**Drejtorja e Financës dhe Buxhetit**

Xhemal Haxhia



**<sup>1</sup> Shënime:**

- Numrat rendor (1,2,3,..) tregojnë numrin dhe radhën e personave të cilët kanë diskutuar gjatë konsultimit. Në kllapa janë shënuar emrat/inicialet apo zona/ kategoria që përfaqësojnë.
- Theksojmë se procesverbali është hartuar kryesisht mbi bazën e perifrastimeve dhe përmbledhjes. Në pjesën e parë të procesverbalit në çdo paragraf paraqiten perifrastime sipas radhës së prezantimeve. Në pjesën e dytë, parashtrihen fillimisht sygjerimet/mendimet nga audienca dhe pastaj sipas rasteve replika përkatëse.





